

**SYLLABUSET E MODULEVE TË PROGRAMIT  
BACHELOR NË INFIERMIERI TË PËRGJITHSHME**

Emërtimi i modulit		<b>Terminologji mjekesore</b>		<b>KODI: INF 110</b>
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit të përgjithshëm		
Përshkrimi i modulit		Terminologjia mjekësore është një lëndë në të cilën studentët marrin njohuri mbi termat më të përdorshme latine dhe greke, fjalëformimi në këto gjuhë, morfologji, formim i recetës si dhe përdorimi i tyre klinik. Të kuptojnë e të përdorin shprehje të jetës së përditshme si dhe të jenë të aftë të përkthejnë materiale të shkencës mjekësore.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	100 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>7 ETCS = 175 orë</b>		
		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
Format e mësimdhënies	Leksione	4,5	45	67,5
	Ushtrime	2,5	30	32,5
	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>75</b>	<b>100</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik  45 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjuha Latine dhe Mjekësia. Fonetika (Alfabeti Latin). Klasifikimi i tingujve. (1 ore)</li> <li>2. Shqiptimi i zanoreve, bashkëtingëlloreve. (1 ore)</li> <li>3. Bashkime tingujsh me bashkëtingëlloren H. Bashkëtingëllore të dyfishta. (1 ore)</li> <li>4. Diftongjet (Dyzanoret). Shqiptimi i diftongjeve. (1 ore)</li> <li>5. Ndarja e fjalëve në rrokje. Rregullat e theksimit. (1 ore)</li> <li>6. Fjalet me origjinë latine (1 ore)</li> <li>7. Fjalet me origjinë greke. (1 ore)</li> <li>8. Terminologji mjekësore (1 ore)</li> <li>9. Morfologjia. Emri, Rasat. Lakimi i emrit. Lakimi i parë. (1 ore)</li> <li>10. Percaktimi i temes dhe rrenjes së fjalëve në gjuhën latine. (1 ore)</li> <li>11. Parashtesat (1 ore)</li> <li>12. Folja (zgjedhimi, mënyra, trajta). (1 ore)</li> <li>13. Zgjedhimi i foljes latine (zgjedhimi i I, II, III, IV). (1 ore)</li> <li>14. Parashtesat në gjuhën latine. (1 ore)</li> <li>15. Terminologji mjekësore. (1 ore)</li> <li>16. Lakimi i dytë. Shembuj Lakimi mbiemrash të lakimit I dhe II. Përshatja e mbiemrit me emrin. (1 ore)</li> <li>17. Prapashtesat. Terminologji mjekësore. (1 ore)</li> <li>18. Folja (mbaresat vetore të foljes, trajta pësore) Koha e tashme e mënyrës dëftore të trajtës pësore (zgjedhimi I, II, III, IV). (1 ore)</li> <li>19. Terminologji mjekësore greko-latine. (1 ore)</li> <li>20. Lakimi i tretë. (1 ore)</li> <li>21. Tipi i parë i lakimit të tretë (me karakter bashkëtingëllor). (1 ore)</li> <li>22. Emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjëanëse të lakimit të tretë. (1 ore)</li> <li>23. Tipi i dytë i lakimit të tretë (tipi i përzier). (1 ore)</li> <li>24. Tipi i tretë i lakimit të tretë (tipi me zanore). (1 ore)</li> <li>25. Mbiemrat e lakimit të tretë; Pjesorja e kohës së tashme veprare. Mënyra lidhore, mbaresat vetore të mënyrës lidhore, formimi i kohës së tashme. (1 ore)</li> <li>26. Terminologji mjekësore, fjalet e perbera. (1 ore)</li> <li>27. Lakimi i Katërt. Lakim emrash të lakimit të katërt bashkë me mbiemra. Lakimi i Pestë. Lakim emrash të lakimit të pestë me mbiemra. (1 ore)</li> <li>28. Tabela përmbledhëse e mbaresave të emrave latinë në rasën emërore njëjës. (1 ore)</li> <li>29. Tabela. përmbledhëse e mbaresave të rasës gjinore të të pesë lakimeve. (1 ore)</li> </ol>		

	<p>30. Ndajfoljet, shkallët e krahasimit, shkallë të parregullta. (1 ore)</p> <p>31. Terminologji mjekesore. (1 ore)</p> <p>32. Organet dhe Sistemet (1 ore)</p> <p>33. Sistemi i Frymëmarrjes (1 ore)</p> <p>34. Sistemi Kardiovaskular (1 ore)</p> <p>35. Sistemi Nervor (1 ore)</p> <p>36. Sistemi Urinar (1 ore)</p> <p>37. Sistemi Riprodhues Femëror. Sistemi Riprodhues Mashkullor (1 ore)</p> <p>38. Sistemi Endokrin (1 ore)</p> <p>39. Sistemi Muskuloskeletor (1 ore)</p> <p>40. Sistemi i Organeve të Tretjes. Sistemi Limfatik (1 ore)</p> <p>41. Terminologji mjekesore (1 ore)</p> <p>42. RECETA. Paraqitja e jashtme e recetës (1 ore)</p> <p>43. Përmbajtja e recetës, modeli i një recete të përbërë (1 ore) Shkurtimet më të zakonshme të recetave (1 ore)</p> <p>44. Format më kryesore të barnave (1 ore)</p> <p>45. Kartela infermiore dhe terminologjia mjekesore. (1 ore) Njohuritë themelore, mbyllje. (1 ore)</p>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ "Gjuha latine", për fakultetin e mjekesise, Nermin Basha (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> <li>○ "Terminologjia latine dhe aplikimi i dokumentacionit infermieror", Yllka Bilushi. 2009 (FSHP-UV)</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Agard, walter, `Medical Greek and Latin at a glance`, 2nd ed, N.Y., Hoeber, 1937.</li> <li>○ Spilman, Mignonette, `Medical Latin and Greek`, Ann Arbor, Edwards Bros., i 946. Arranged somewhat differently –from Agard's work, it starts with the Latin, being the more familiar language and leads slowly to the more difficult Greek.</li> <li>○ Andrews, Edmund, `Medical terminology`, Annals of Medical History, io: 180-198, 1928.</li> <li>○ Andrews, Edmund, `A history of scientific English`. The story of its evolution based on a study of biomedical terminology, N-Y.</li> <li>○ Smith, 1947. A posthumous work of the same author, elaborating on the above –mentioned article, studying all linguistic elements in medical terminology against their historical background.</li> <li>○ Jaeger, Edmund C., `A source book of biological names and terms`, Springfield, Ill., Thomas, 1944. An alphabetical dictionary.</li> </ul>

Emërtimi i modulit		<b>Shëndet Publik dhe mjedisor</b>		<b>KODI: INF 260</b>
Viti		II		
Semestri		II		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit të përgjithshëm		
Përshkrimi i modulit		<p>Shëndeti publik: Trajton kryesisht një grup problemesh që lidhen me mjedisin (ajri, uji, toka), kontrolli i sëmundjeve infektive, edukimi shëndetësor si dhe organizimi i shërbimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Epidemiologjia: Ky modul studion adresimin e çështjeve të tilla si rritja apo ulja e sëmundjeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, në popullata të ndryshme, si dhe në subjekte të ndryshme brenda të njëjtës popullatë.</p> <p>Metodologjia e kërkimit shkencor në Infermieri: Në këtë modul trajtohen teknikat dhe metodat bazë me të cilat operohet në fushën e kërkimit shkencor dhe specifikat e studimeve shkencore infermierore.</p>		
Ngarkesa në orë	Auditor	75 orë		
	Studim individual	125 orë		
Kreditet		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
Format e mësimdhënies		Kredite (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
		Shëndet Publik = 4.5 ECTS		
	Leksione	3	30	45
	Ushtrime	1	12	13
	Seminare	0,5	4	8.5
		Epidemiologji = 3.5 ECTS		
	Leksione	1,5	15	22.5
	Ushtrime	1	12	13
	Projekte kursi	1	2	23
	<b>Total</b>	<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik		<p><b>Shëndeti Publik</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Hyrje në shëndetin publik. Koncepte mbi shëndetin. (1 orë)</li> <li>Faktorët përcaktues të shëndetit. (1 orë)</li> <li>Sistemi shëndetësor në Shqipëri. (1 orë)</li> <li>Institucionet shëndetësore, detyrat e tyre. (1 orë)</li> <li>Organet dhe institucionet parandaluese. (1orë)</li> <li>Strukturat e shërbimit shëndetësor në infermieri. (1 orë)</li> <li>Koncepte bashkëkohore në fushën e infermieristikës(1 orë)</li> <li>Shërbimi shëndetësor në ndërmarrje. (1 orë)</li> <li>Llojet e parandalimit në shëndetin publik. (1 orë)</li> <li>Promocioni shëndetësor. Edukimi dhe promovimi shëndetësor. (1 orë)</li> <li>Modele dhe përfaqje në promovimin shëndetësor. (1 orë)</li> <li>Promocioni nëpërmjet Mas – Medias. Promocioni shëndetësor në vendin e punës. Promocioni shëndetësor në shkollë. (1 orë)</li> <li>Promocioni shëndetësor në shërbimet spitalore dhe parësor. (1 orë)</li> <li>Shëndeti dhe stili i jetës. (1 orë)</li> <li>Konceptet bazë epidemiologjike mbi sëmundjet. (1 orë)</li> <li>Shëndeti riprodhues. Detyrat e qëndrës së planifikimit familjar. (1 orë)</li> <li>Duhani, ndikimi mbi shëndet. Parandalimi. (1 orë)</li> <li>Droga, ndikimi mbi shëndet. Parandalimi. (1 orë)</li> <li>Alkooli, ndikimi mbi shëndet. Parandalimi. (1 orë)</li> <li>Infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe parandalimi i tyre. (1 orë)</li> <li>Aksidentet rrugore, problem shqetësues i shëndetit publik (1orë)</li> <li>Faktorët biologjik të mjedisit. Impakti mbi shëndetin. (1orë)</li> <li>Faktorët social të mjedisit. Impakti mbi shëndetin. (1orë)</li> <li>Higjiena e qendrave të banuara dhe e banesave. (1orë)</li> <li>Toka dhe shëndeti. Ngrohja dhe ndricimi i mjediseve të banuara. (1orë)</li> <li>Higjiena e ujit. Rëndësia fiziologjike dhe higjienike. Ndotja dhe vetite bakteriologjike.</li> <li>Sistemi i furnizimit të ujit të pijshëm. Metodatat e perpunimit dhe monitorimi të ujit. Ndertimi i ujesjellesit. (1orë)</li> <li>Higjiena e institucioneve shëndetësore. (1orë)</li> <li>Ligji mbi inspektoriatin sanitar. (1 orë)</li> </ol>		
45 orë leksione				

	<p>30. Komponentet perberes te racionit ushqimor dhe rendesia mbi shendetin. Bazat e konservimit te ushqimeve. (1orë)</p> <p><b>Epidemiologji dhe kërkim shkencor</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hyrje në epidemiologji. (1 orë)</li> <li>2. E ardhmja e kërkimit shkencor në infermieri. (1 orë)</li> <li>3. Studimet e vdekshmerise ne popullate. Madhesite njehsuese te vdekshmerise. (1 orë)</li> <li>4. Incidenca. Prevalenca. Lidhja midis incidences dhe prevalences. (1 orë)</li> <li>5. Klasifikimi i studimeve epidemiologjike. Studimet kohort, rast-kontroll dhe transversale. (1 orë)</li> <li>6. Programet depistuese. Kriteret e nje programi te mire depistues, efektet e mundshme anesore te nje program depistues. (1 orë)</li> <li>7. Sensitiviteti, specificiteti. Vlera parashikuese positive dhe vlera parashikuese negative. (1 orë)</li> <li>8. Formulimi i qëllimit dhe objektivave të studimit. (1 orë)</li> <li>9. Përzgjedhja e popullatës, rasteve dhe kontrolleve. (1 orë)</li> <li>10. Hartimi i pyetsorëve. Përdorimi i burimeve dokumentare. (1 orë)</li> <li>11. Interpretimi i të dhënave. (1 orë)</li> <li>12. Shkrimi i review (studimi i literaturës) (1 orë)</li> <li>13. Shkrimi i studimeve rast-raport. (1 orë)</li> <li>14. Shkrimi i studimeve klinike dhe komunitare. (1 orë)</li> <li>15. Shkrimi i temës së diplomës. (1 orë)</li> </ol>
<p><i>Literatura bazë</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ ‘Shëndet Publik’ G. Qirjako, G. Burazeri, E. Roshi, V. Hasani 2010 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li> <li>○ ‘Epidemiologjia’ E. Roshi, G. Burazeri, 2010 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li> <li>○ ‘Shëndeti Publik’ E. Roshi, G. Burazeri 2006 (Fakulteti i Mjekësisë - UV)</li> </ul>
<p><i>Literatura ndihmëse</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ “Key Concepts in Public Health (SAGE Key Concepts series) Frances Wilson Andi Mabhala 2008</li> <li>○ “Foundations for Health Promotion (Public Health and Health Promotion)” Jennie Naidoo BSc MSc PGDip PGCE, Jane Wills BA MA MSc PGCE Professor 2009</li> <li>○ “Metodología de la investigación” Edelsys Hernández Meléndrez. Escuela Nacional de Salud Pública</li> <li>○ 2006, <a href="http://biblioteca.ucv.cl/site/servicios/documentos/como_escribir_tesis.pdf">http://biblioteca.ucv.cl/site/servicios/documentos/como_escribir_tesis.pdf</a></li> <li>○ “Metodología de la Investigación”, <a href="http://www.aniortenic.net/progr_asignat_met_investigac4.htm">http://www.aniortenic.net/progr_asignat_met_investigac4.htm</a></li> <li>○ “Metodología básica de investigación en enfermería” Francisco Xavier Santos Heredero, Carlos A. Rodríguez Arias, Rosario Rodríguez Ballesterro Ediciones Díaz de Santos, 2003, <a href="http://books.google.al/books?id=W-Qae--fG2UC&amp;printsec=frontcover&amp;hl=it&amp;source=gbs_ge_summary_r&amp;cad=0#v=onepage&amp;q&amp;f=false">http://books.google.al/books?id=W-Qae--fG2UC&amp;printsec=frontcover&amp;hl=it&amp;source=gbs_ge_summary_r&amp;cad=0#v=onepage&amp;q&amp;f=false</a></li> </ul>

Emërtimi i modulit		<b>Bazat e Biologjisë</b>		<b>KODI: BIO 102</b>
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit të përgjithshëm		
Përshkrimi i modulit		Bazat e Biologjisë, ka si objektivi të pajisë studentin me disa nga konceptet bazë të teorisë qelizore dhe të fiziologjisë dhe biokimisë së qelizës. Qëllimi i lëndës është konceptimi i modeleve dhe mekanizmave biokimike të cilat bëjnë të mundur realizimin e proceseve fiziologjike qelizore si fotosinteza, frymëmarrja, cikli qelizor, riprodhimi dhe zhvillimi si dhe tejçimi i tipareve nëpërmjet gjenetikës.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	100 orë		
Kreditet		<b>7 ECTS = 175 orë mësimore</b>		
Format e mësimdhënies		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
		Biologjia e përgjithshme = 4.5 ECTS		
	Leksione	3	30	45
	Ushtrime	1.5	18	19.5
		Gjenetika = 2.5 ECTS		
	Leksione	1,5	15	22.5
	Ushtrime	1	12	13
	<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>75</b>	<b>100</b>
Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik  45 orë leksione		<p align="center"><b>Biologjia e përgjithshme</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Njohja me programin dhe kërkesat e lëndës. (1 orë)</li> <li>Karakteristikat e përgjithshme të qënieve të gjalla. (1 orë)</li> <li>Aftësia e rritjes. (1 orë)</li> <li>Teoria qelizore. Qeliza eukariote dhe prokariote. (1 orë)</li> <li>Rëndësia biologjike e ujit. Uji si tretës. (1 orë)</li> <li>Uji dhe membranat biologjike. (1 orë)</li> <li>Klasat kryesore të përbërjeve biologjike. (1 orë)</li> <li>Karbohidratet. (1 orë)</li> <li>Makromolekulat biologjike dhe informacioni biologjik. (1 orë)</li> <li>Vetite acido-bazike të proteinave. (1 orë)</li> <li>Denatyrimi dhe rinatyrimi i proteinave. (1 orë)</li> <li>Acidet nukleike. Acidi dezoksiribonukleik (ADN). (1 orë)</li> <li>Qeliza prokariote. Morfologjia. Metabolizmi. (1 orë)</li> <li>Qeliza eukariote. Ndarjet në qelizën eukariote. (1 orë)</li> <li>Rimarrja dhe shpërndarja e proteinave drejt lokalizimeve të ndryshme në qelizë. (1 orë)</li> <li>Ekzocitoza dhe endocitoza. (1 orë)</li> <li>Mitokondritë. Organelet që karakterizojnë qelizën bimore. (1 orë)</li> <li>Bërthama dhe bërthamëzat. (1 orë)</li> <li>Katalizatorët biologjikë. (1 orë)</li> <li>Enzimët. Energjia e aktivizimit në reaksionet kimike. (1 orë)</li> <li>Format e energjisë të përdorura nga qëniet e gjalla. (1 orë)</li> <li>Organizmat fototrofe dhe organizmat kimiotrofe. (1 orë)</li> <li>Roli i adenozintrifosfatit (ATP) në brëndësi të qënieve të gjalla. (1 orë)</li> <li>Organizmat autotrofe dhe organizmat heterotrofe. (1 orë)</li> <li>Përdorimi i materies dhe energjisë. (1 orë)</li> <li>Fermentimi dhe frymëmarrja qelizore. (1 orë)</li> <li>Cikli qelizor mitotik. (1 orë)</li> <li>Mitoza, rregullimi i ciklit mitotik dhe apoptosi. (1 orë)</li> <li>Riprodhimi seksual. Cikli ovarik, uterin dhe fekondimi. (1 orë)</li> <li>Viruset. Zhvillimi i infeksionit viral në qelizën eukariote. (1 orë)</li> </ol> <p align="center"><b>Gjenetika Mjekësore.</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Roli i gjenetikës në mjekësi. (1 orë)</li> <li>Bazat kromozomike të hereditetit. (1 orë)</li> <li>Gjenoma humane: struktura dhe funksionet e gjeneve dhe kromozomeve. (1 orë)</li> </ol>		

	<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Modele të trashëgimisë nga një gen i vetëm. (1 orë)</li> <li>5. Variacionet gjenetike tek individi. Mutazioni dhe polimorfizmi. (1 orë)</li> <li>6. Principet e citogjenetikës klinike. Citogjenetika klinika. (1 orë)</li> <li>7. Anomalitë kromozomike. (1 orë)</li> <li>8. Bazat molekulare të sëmundjeve- Hemoglobinopatitë. (1 orë)</li> <li>9. Gjenetika e sistemit imunitar. Kompleksi i histokompatibilitetit HLA. (1 orë)</li> <li>10. Gjenetika e patologjive nga trashëgimia komplekse ose shumëfaktorëshe. (1 orë)</li> <li>11. Gjenetika e kancerit. Gjenetika e grupeve të gjakut. Faktori Rhexus. (1 orë)</li> <li>12. Sëmundjet farmakogjenetike. (1 orë)</li> <li>13. Gjenetika e zhvillimit. Diagnoza prenatale. (1 orë)</li> <li>14. Trajtimi i sëmundjeve gjenetike. (1 orë)</li> <li>15. Konsulenca gjenetike dhe vlerësimi i rrezikut. Gjenetika dhe shoqëria humane. (1 orë)</li> </ol>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ 'Biologjia' M.Shehu 2005 (Departamenti i Biologjisë - UV)</li> <li>○ 'Biologjia' T.Rexha 2000 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ S. Mander (1996); Biology.</li> <li>○ E.Kormelink; R.Smith: Concepts in Biology.</li> <li>○ B.Riter et al(1996): Biology, (British Columbia Edition)</li> <li>○ H.Kiçaj; D.Kasëmi (2013); Bazat e Biologjisë.</li> </ul>

Emërtimi i modulit		<b>Biokimi</b>		<b>KODI: BIO 222</b>
Viti		II		
Semestri		II		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit të përgjithshëm		
Përshkrimi i modulit		Biokimia është dega e biologjisë që studion proceset kimike në organizmat e gjallë. E lindur si një ndërthurje e dy shkencave, biologjisë dhe kimisë, ajo merret me studimin e strukturave dhe funksioneve të komponentëve qelizorë si: proteinat, karbohidratet, lipidet, acidet nukleike dhe biomolekula të tjera që ndërtojnë organizmat e gjalla dhe njeriun.		
Ngarkesa në orë	Auditor	75 orë		
	Studim individual	125 orë		
<b>Kreditet</b>		<b>8 ECTS = 200 orë mësimore</b>		
		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
Format e mësimdhënies	Leksione	4.5	45	67,5
	Ushtrime	2	24	26
	Seminare	0,5	4	8,5
	Projekte kursi	1	2	23
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik  45 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> <li>Objekti i biokimisë.</li> <li>Përbërësit inorganikë, të dhëna biokimike.</li> <li>Uji, ndërtimi kimik, vetitë, rëndësia për organizmin e njeriut.</li> <li>Pehashi (pH) i organizmit.</li> <li>Membrana qelizore.</li> <li>Transporti përmes membranës qelizore.</li> <li>Klasifikimi i proteinave.</li> <li>Aminoacidet.</li> <li>Peptidet, proteinat, strukturat e proteinave.</li> <li>Vetitë fizike dhe kimike të proteinave.</li> <li>Lidhjet kimike tek proteinat.</li> <li>Denatyrimi i proteinave.</li> <li>Proteinat e përbëra.</li> <li>Ndërtimi i ADN-së dhe ARN-së.</li> <li>Proteinat me ngjyrë.</li> <li>Karbohidratet. Rëndësia, përbërja, klasifikimi.</li> <li>Monosakaridet.</li> <li>Disakaridet.</li> <li>Polisakaridet.</li> <li>Lipidet.</li> <li>Lipidet e thjeshta.</li> <li>Lipidet komplekse.</li> <li>Enzimët.</li> <li>Vitaminat. Vitaminat e patretshme në ujë.</li> <li>Vitaminat e tretshme në ujë.</li> <li>Konceptet bazë energjetike.</li> <li>Metabolizmi i lëndëve.</li> <li>Glikoliza.</li> <li>Transporti i elektroneve dhe H<sup>+</sup> (fosforilimi oksidativ).</li> <li>Cikli i Krebsit.</li> <li>β-oksidimi i acideve lyrore.</li> <li>Katabolizmi i azotit të aminoacideve.</li> <li>Katabolizmi i hemës.</li> <li>Biosinteza e karbohidrateve.</li> <li>Biosinteza e acideve lyrore.</li> <li>Biosinteza e aminoacideve.</li> <li>Biosinteza e hemoglobinës.</li> <li>Acidet nukleike dhe sinteza e proteinave.</li> <li>Dyfishimi i ADN –së.</li> <li>Biokimia e gjakut. Koagulimi i gjakut.</li> <li>Ekuilibri acido-bazik i organizmit.</li> </ol>		

	42. Sistemet tampone të gjakut. 43. Urina. 44. Neurotransmetuesit. 45. Hormonet. Ndërtimi kimik. Klasifikimi. Imunoglobulinat.
<i>Literatura bazë</i>	'Biokimia' Hajdar Kicaj 2009 (Departamenti i Biologjisë - UV)
<i>Literatura ndihmëse</i>	Biokimia. Artan Trebicka Tirane 2005 Biochemistry. Bettelheim and March 1991



Emërtimi i modulit		Anatomi Humane I		KODI: INF 130
Viti		I		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi i modulit		Anatomia e njeriut është studim shkencor i morfologjisë së trupit të njeriut. Në lëndën e anatomisë studentët do të marrin njohuri të plota mbi organizimin anatomik të trupit të njeriut, ndërtimin e organeve dhe sistemeve .Studentët do të mësohen të njohin trupin e njeriut,formën dhe strukturën e tij në kushte normale.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	75 orë		
	Jashtë auditorit	125 orë		
Kreditet		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
		Kredite (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
Format e mësimdhënies	Leksione	4.5	45	67,5
	Laboratore	0,5	9	3,5
	Seminare	2,5	20	42,5
	Projekte kursi	0,5	1	11,5
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik		<p style="text-align: center;"><b>Anatomia normale</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Terminologjia anatomike,organizimi anatomik i trupit te njeriut, aparati i kockave,osteologjia(1 orë)</li> <li>2. Kolona vertebrale (2orë)</li> <li>3. Kafazi i kraharorit(1 orë)</li> <li>4. Kafka,cranium (1 orë)</li> <li>5. Nofulla e siperme,maxilla (1 orë)</li> <li>6. Kockat e vogla te fytyres (1 orë)</li> <li>7. Nofulla e poshtme,mandibula,morfologjia e brendshme e kafkes,regjionet e kafkes (1 orë)</li> <li>8. Skeleti i gjymtyreve te siperme(2 orë)</li> <li>9. Skeleti i gjymtyreve te poshtme (1 orë)</li> <li>10. Lidhjet e kockave (1 orë)</li> <li>11. Lidhjet e shtylles kurrizore. (1 orë)</li> <li>12. Artikulacioni i nofullës dhe lidhjet e gjymtyreve te siperme. (2 orë)</li> <li>13. Artikulacionet e kockave te legenit. (1 orë)</li> <li>14. Aparati Muskular,te dhena te pergjithshme. (1 orë)</li> <li>15. Miologjia speciale. (1 orë)</li> <li>16. Muskujt e shpines. (1 orë)</li> <li>17. Muskujt e thelle te shpines. (2orë)</li> <li>18. Mujskujt e kraharorit. (1 orë)</li> <li>19. Muskujt e barkut. (1 orë)</li> <li>20. Muskujt e kokes. (2 orë)</li> <li>21. Muskujt e kockes hyoide. (1 orë)</li> <li>22. Muskujt e thelle te qafes. (1 orë)</li> <li>23. Muskujt e anesive te siperme. (2 orë)</li> <li>24. Muskujt e anesise se poshtme. (1 orë)</li> <li>25. Topografia e anesise se poshtme. (1 orë)</li> <li>26. Te dhena te pergjithsme mbi te mbrendesirat,splanchnologia. (1 orë)</li> <li>27. Hapesira e vertete e gojes,gjuha,muskujt e gjuhes. (1 orë)</li> <li>28. Gjendrrat e hapesires se gojes. (1 orë)</li> <li>29. Faringu,ezofagu. (1 orë)</li> <li>30. Stomaku. (1 orë)</li> <li>31. Zorret e holla. (1 orë)</li> <li>32. Zorret e trasha. (1 orë)</li> <li>33. Melcia,qeska e temthit ,pankreasi. (1 orë)</li> <li>34. Kaviteti abdominal,peritoneumi(1 orë)</li> <li>35. Aparati i frymemarrjes. (3 orë)</li> <li>36. Aparati urinar. (2 orë)</li> <li>37. Aparati i organeve seksuale mashkullore. (1 orë)</li> <li>38. Aparati i organeve genitale femerore,perineum. (1 orë)</li> </ol>		
45 orë leksione				

<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Anatomia Normale e Njeriut,, Sofika Qamirani,Mimoza Canga. Tirane 2014.</li> <li>○ Atlante di anatomia umana’ Frank H.Netter,M.D .Novartis Edizione.1999.</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Anatomia e Njeriut,, Drita Totozani, Sofika Qamirani QSUT. 2014</li> <li>○ Concepts of Human Anatomy and Physiology, 4-th edition, Kent M. Van De Graaff, Stuart Ira Fox, ISBN 0-697-16076-9</li> <li>○ Gray’s Anatomy, 13-th edition, <u>Henry Gray</u> ,T. Pickering Pick ,Robert Howden. ISBN-13: 978-0914294085</li> </ul>

Emërtimi i modulit		Anatomia normale II		KODI: INF 131
Viti		I		
Semestri		II		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi i modulit		Kjo pjesë e lëndës merret me studimin e sistemit nervor qendror, formën, ndërtimin, strukturën dhe funksionin e sistemit nervor të njeriut në kushte normale. Si dhe me studimin e aparatit kardio –vaskular. Pjesa e dytë,anatomia patologjike ka si synim trajtimin e ndryshimeve që pëson organizmi ynë në kushtet e sëmundjes, hap pas hapi. Për këtë arsye anatomia patologjike ka disa metoda studimi të cilat ndihmojnë studentin të njoh dhe studiojë procesin e zhvillimit të sëmundjeve të ndryshme.		
Ngarkesa në orë	Auditor	75 orë		
	Studim individual	125 orë		
Kreditet		8 ETCS = 200 orë		
		Kreditet (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
		Anatomia normale = 4 ECTS		
Format e mësimdhënies	Leksione	2.5	25	37.5
	Laboratore	0,5	9	3,5
	Seminare	1	8	17
	Anatomia patologjike = 4 ECTS			
	Leksione	2	20	30
	Seminare	1.5	12	25.5
	Projekte kursi	0,5	1	11,5
<b>Gjithsej</b>		<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik		<p><b>Anatomi normale (vazhdim)</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Njohja me programin dhe kërkesat e lëndës. (1 orë)</li> <li>Aparati i qarkullimit të gjakut. (1 orë)</li> <li>Zemra. (1 orë)</li> <li>Arteriet.Arteriet e qarkullimit të vogel të gjakut. (1 orë)</li> <li>Arteria carotia interna . (1 orë)</li> <li>Arteriet e gjymtyreve të sipërme. (1 orë)</li> <li>Aorta torakale. (1 orë)</li> <li>Aorta abdominale. (1 orë)</li> <li>Venat (1 orë)</li> <li>Venat e qarkullimit të madh të gjakut. (1 orë)</li> <li>Vena cava inferior dhe venat e anesive të poshtme. (1 orë)</li> <li>.Sistemi Limfatik (1 orë)</li> <li>Sistemi nervor. (1 orë)</li> <li>Palca e kurrizit. (1 orë)</li> <li>Nervat spinale. (1 orë)</li> <li>Truri i vogel,cerebellum (1 orë)</li> <li>Truri i mesem,mezencephaloni. (1 orë)</li> <li>Telencephalon,truri i madh. Qendrat kortikale. (1 orë)</li> <li>Nervat kraniale,cifti i I-VI. (1 orë)</li> <li>Nervat kraniale,cifti VII-XII. (1 orë)</li> <li>Rruget projektuese. (1 orë)</li> <li>Nervat e shpines. (1 orë)</li> <li>Sistemi nervor vegjetativ. (1 orë)</li> <li>Sistemi endokrin. (1 orë)</li> <li>Organet e shqisave,veshi dhe syri. (1 orë)</li> </ol> <p><b>Anatomia Patologjike</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Anatomia patologjike,metodat e studimit. (1 orë)</li> <li>Crregullimet e qarkullimit të gjakut,hemoragjia (1 orë)</li> <li>Tromboza,embolia. (1 orë)</li> <li>Iskemia,infarkti,edemat. (1 orë)</li> <li>Demtimi qelizor,nekroza. (1 orë)</li> </ol>		
45 orë leksione				

	<p>31. Cregullimet e metabolizmit. (1 orë)</p> <p>32. Cregullimet e metabolizmit te proteinave. (1 orë)</p> <p>33. Cregullimet e metabolizmit te yndyrnave. (1 orë)</p> <p>34. Cregullimet e metabolizmit te karbohidrateve. (1 orë)</p> <p>35. Cregullimet e metabolizmit te kriperave minerale (1 orë)</p> <p>36. Keqformimet e lindura (1 orë)</p> <p>37. Inflamacioni. (1 orë)</p> <p>38. Tumoret (1 orë)</p> <p>39. Pathologjia e aparatit kardio-vaskular (1 orë)</p> <p>40. Pathologjia e aparatit pulmonar (1 orë)</p> <p>41. Pathologjia e aparatit tretes (1 orë)</p> <p>42. Pathologjite e heparit dhe rrugeve biliare (1 orë)</p> <p>43. Pathologjite e aparatit urinar (1 orë)</p> <p>44. Pathologjite e sistemit hemopoetik (1 orë)</p> <p>45. Pathologjite e sistemit endokrin (1 orë)</p>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Anatomia Normale e Njeriut,, Sofika Qamirani,Mimoza Canga. Tirane 2014.</li> <li>o Atlante di anatomia umana' Frank H.Netter,M.D .Novartis Edizione.1999.</li> <li>o 'Anatomia Patologjike e përgjithshme e speciale' Prof.Dr Shyqyri Subashi (Fakulteti i Mjekësisë - UT) 2000</li> <li>o 'Patologjia Morfologjike'. Diana Kozdine (FSHP-UV) 2006</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Anatomia e Njeriut,, Drita Totozani, Sofika Qamirani QSUT. 2014</li> <li>o Concepts of Human Anatomy and Physiology, 4-th edition, Kent M. Van De Graaff, Stuart Ira Fox, ISBN 0-697-16076-9</li> <li>o Gray"s Anatomy, 13-th edition, <u>Henry Gray</u> ,<u>T. Pickering Pick</u> ,<u>Robert Howden</u>. ISBN-13: 978-0914294085</li> </ul>

<i>Emërtimi i modulit</i>		<b>Histologji dhe mikrobiologji</b>		<b>KODI: INF 140</b>
<i>Viti</i>		I		
<i>Semestri</i>		I		
<i>Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit</i>		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
<i>Përshkrimi i modulit</i>		Histologjia bën pjesë në lëndët paraklinike dhe ndihmon studentin të marrë njohuri bazë për ndërtimin e trupit të njeriut, duke filluar studimin që nga qeliza. Nëpërmjet mikrobiologjisë studenti merr njohuri për mikroorganizmat që invadojnë trupin e njeriut dhe e ndihmon për të kuptuar më mirë patologjitë infektive.		
<i>Ngarkesa në orë</i>	<i>Në auditore</i>	75orë		
	<i>Jashtë auditorit</i>	125orë		
<i>Kreditet</i>		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
<i>Format e mësimdhënies</i>		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
		Histologji = 5.5 ECTS		
	<i>Leksione</i>	3	30	45
	<i>seminare</i>	2.5	20	42.5
		Mikrobiologjia = 2.5 ECTS		
	<i>Leksione</i>	1.5	15	22.5
	<i>Laboratore</i>	0.5	9	3.5
	<i>Projekte</i>	0.5	1	11.5
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>75</b>	<b>125</b>
<i>Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik</i>	<p style="text-align: center;"><b>Histologjia</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Histologjia,objekti,historiku,metodat e studimit</li> <li>2.Citologji,njohuri te pergjithshme per qelizat,membrana qelizore</li> <li>3.Citologji,organelet qelizore</li> <li>4.Citologji,berthama e qelizes</li> <li>5.Indi epitelial</li> <li>6.Indi lidhor</li> <li>7.Gjaku</li> <li>8.Indi mieloid,palca e kockave</li> <li>9.Hemopoeza</li> <li>10.Indi limfoid,timusi dhe nyjet limfatike</li> <li>11.Indi limfoid,shpretka</li> <li>12.Indi kercor dhe indi kockor</li> <li>13.Indi muskulor</li> <li>14.Indi nervor</li> <li>15.Enet e gjakut</li> <li>16.Zemra</li> <li>17.Sistemi respirator,kaviteti nazal,laringu,faringu,trakea</li> <li>18.Sistemi respirator,pema bronkiale,mushkerite</li> <li>19.Aparati tretes,gjuha,tonsilat dhe gjendrat e peshtymes</li> <li>20.Aparati tretes,ezofagu,stomaku,zorret</li> <li>21.Aparati tretes,melcia</li> <li>22.Aparati tretes,pankreasi</li> <li>23.Gjendrat me sekretim te brendshem,hipofiza dhe gjendra tiroide</li> <li>24.Gjendrat me sekretim te brenshshem,gjendra paratiroide dhe gjendra mbiveshkore</li> <li>25.Aparati urinar,histologjia e veshkes,nefroni</li> <li>26.Lekura</li> <li>27.Syri</li> <li>28.Veshi</li> <li>29.Sistemi riprodhues femeror</li> <li>30.Sistemi riprodhues mashkullor</li> </ol> <p style="text-align: center;"><b>Mikrobiologji</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Hyrje ne Mikrobiologji ( 1 orë)</li> <li>2.Qelizat eukariote dhe prokariote</li> <li>3.Qelizat bakteriale</li> <li>4. Viruset</li> <li>5.Protozoaret: kerpudhat dhe algat</li> <li>6.Fiziologjia e mikroorganizmave</li> </ol>			
45 orë leksione				

	<p>7.Rritja e baktereve  8.Gjenetika bakteriale  9.Mikroflora normale e trupit te njeriut  10.Faktoret qe ndikojne ne rritjen e baktereve  11.Metodat antimikrobiale fizike dhe kimike  12.Infeksioni dhe shkaktaret mikrobiale te tij  13.Epidemiologjia dhe transmetimi i semundjes  14.Imuniteti jospecifik  15.Imuniteti specifik</p>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o 'Histologjia' Xh.Ceka, 2010 (Fakulteti i Infermierisë - UT)</li> <li>o 'Mikrobiologjia e përgjithshme' B.Byku, 2010 (Fakulteti i Infermierisë - UT)</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o 'Histologjia' E.Kone, Xh.Ceka (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> <li>o 'Atlas i Histologjisë' Xh.Ceka, 2002 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> <li>o 'Mikrobiologjia' B.Andoni, B. Byku(Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> </ul>

Emërtimi i modulit		Principet bazë të Infermierisë		KODI: INF 160
Viti		I		
Semestri		II		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi i modulit		Principet bazë të Infermierisë është një lëndë formuese profesionale, e bazuar në tematikat komplekse që shtjellon si procedurat e emergjencës, principet shkencore, dokumentacioni infermieror, teknikat kryesore infermiore. Në këtë modul futet dhe praktika infermiore e cila në vitin e parë synon ti njohë studentët me organizmin shëndetësor në komunitet për të kaluar në vitin pasardhës në shërbimin spitalor.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	92 orë		
	Jashtë auditorit	108 orë		
Kreditet		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
Format e mësimdhënies		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
	Leksione	4.5	45	67.5
	Praktika mësimore	2.5	45	32.5
	Projekte	1	2	23
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>92</b>	<b>103</b>
Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Etika dhe deontologjia. (1orë)</li> <li>2. Privacy dhe infermieri. (1orë)</li> <li>3. Nevojat e rëndësishme tek një person. (1orë)</li> <li>4. Komunikimi human. (1orë)</li> <li>5. Infermieristika, Infermieri. Detyrat. (1orë)</li> <li>6. Infermieri i familjes. (1orë)</li> <li>7. Proçesi infermieror. (1orë)</li> <li>8. Hallkat e proçesit infermieror. (1orë)</li> <li>9. Mbledhja e informacionit. (1orë)</li> <li>10. Diagnozat infermiore. (1orë)</li> <li>11. Planifikimi infermieror. (1orë)</li> <li>12. Zbatimi. (1orë)</li> <li>13. Vlerësimi infermieror. (1orë)</li> <li>14. Parametrat vital(1orë)</li> <li>15. Parametrat vital (1orë)</li> <li>16. Testet dhe procedurat diagnostikuese. (1orë)</li> <li>17. Higjena dhe kujdesi për të. (1orë)</li> <li>18. Aparati lokomotor. (1orë)</li> <li>19. Lëvishmëria e pacientit Imobiliteti(1orë)</li> <li>20. Pozicionet e pacientit në shtrat. (1orë)</li> <li>21. Principet e kujdesit në ushqyerjen e pacientit. (1orë)</li> <li>22. Plagët dhe dekubituset. Kujdesi për to. (1orë)</li> <li>23. Eliminimi urinar. (1orë)</li> <li>24. Eliminimi intestinal. (1orë)</li> <li>25. Administrimi i medikamenteve dhe infermieri(1orë)</li> <li>26. Klasifikimi i medikamenteve(1orë)</li> <li>27. Rregullat e administrimit të medikamenteve (1orë)</li> <li>28. Administrimi per os(1orë)</li> <li>29. Administrimi respirator(1orë)</li> <li>30. Administrimi cutan(1orë)</li> <li>31. Administrimi IM(1orë)</li> <li>32. Terapia venoze periferike(1orë)</li> <li>33. Terapia venoze centrale (1orë)</li> <li>34. Administrimi SC(1orë)</li> <li>35. Administrimi ID(1orë)</li> <li>36. Ekuilibri hidrik(1orë)</li> <li>37. Ushqyerja parenterale(1orë)</li> <li>38. Kimioterapia(1orë)</li> <li>39. Transfuzioni i gjakut. (1orë)</li> <li>40. Sterilizimi. Etapat e sterilizimit. (1orë)</li> </ol>		
45 orë leksione				

	<p>41. Kujdesi për pacientin që do të nënshtrohet një ndërhyrje kirurgjikale. (1orë)</p> <p>42. Kujdesi gjatë ndërhyrjes kirurgjikale. Kujdesi në dhomën e zgjimit. (1orë)</p> <p>43. Kujdesi pas ndërhyrjes kirurgjikale. (1orë)</p> <p>44. Rreziqet profesionale dhe infermieri. (1 orë)</p> <p>45. Dosja infermiere. (1orë)</p>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ “Fundamental of Nursing” Edition 8, 2012. Publisher Elsevier Health Science ISBN – 13 9780323079334 (Përkthyer dhe përgatitur nga Emirjona Kiçaj, Denada Selfo dhe Alida Ramaj)</li> <li>○ Procedurat dhe teknikat Infermiere” E. Kicaj, R. Cercizaj, R. Lalo, A. Ramaj 2010 (FSHP-UV)</li> <li>○ Principet bazë të Infermierisë’ A.Ramaj, E. Kiçaj 2011 “Infermieri dhe administrimi i medikamenteve” A. Ramaj, E. Kicaj 2011 (FSHP-UV)</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ “Basic Nursing – Foundations of Skills &amp; Concepts” L.White, K.M.Campell 2002</li> <li>○ Nursing care. Linda Field and Barbara Smith 2009</li> <li>○ L’infermiere. Manuale teorico pratico di infermieristica” Cristina Fabri 2008</li> </ul>



Emërtimi i modulit		<b>Pediatri</b>		<b>KODI: INF 210</b>
Viti		II		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi i modulit		Në këtë lëndë studentët do të marrin njohuri profesionale në fushën e perinatologjisë dhe patologjive pediatrike. Perinatologjia studion kujdesin shëndetsor për fëmijën e porsalindur dhe trajtimin e problemeve që mund të shfaqen gjatë periudhës neonatale. Gjithashtu studentët do të mësohen të njohin dhe të trajtojnë sëmundjet më të shpeshta të moshës fëmijënore.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	106 orë		
	Jashtë auditorit	94 orë		
Kreditet		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
Format e mësimdhënies		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
		Perinatologjia = 2.5 ECTS		
	Leksione	1.5	15	22.5
	Praktika mësimore	1	20	5
		Patologjitë pediatrike = 5.5 ECTS		
	Leksione	3	30	45
	Praktika mësimore	2	40	10
	Projekte kursi	0.5	1	11.5
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>106</b>	<b>94</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik		<p><b>Kapitulli I: Perinatologjia</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Periudha intrauterine. Metodat e vlerësimit të zhvillimit intrauterin.</li> <li>2. Përshtatja e fetusit me jetën ekstrauterine</li> <li>3. Vuajtja fetale</li> <li>4. Pritja e neonatit normal</li> <li>5. Ekzaminimi klinik i neonatit në term</li> <li>6. Vlerësimi i neonatit në bazë të moshës së barrës dhe përmasave trupore</li> <li>7. I porsalinduri i shëndoshë – në rrezik – i sëmurë</li> <li>8. Reanimacioni neonatal</li> <li>9. Detresi respirator neonatal</li> <li>10. Ikteri neonatal</li> <li>11. Infeksionet neonatale</li> <li>12. Hipotermia dhe hipoglicemia</li> </ol> <p><b>Kapitulli II : Patologjitë pediatrike</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>13. Rinofaringiti akut. Laringiti akut</li> <li>14. Tonsiliti akut. Otiti i mesëm.</li> <li>15. Bronkiti. Bronhektazia.</li> <li>16. Asthma bronkiale.</li> <li>17. Bronkioliti. Fibroza kistike.</li> <li>18. Trupat e huaj në rrugët e frymëmarrjes.</li> <li>19. Pneumonitë.</li> <li>20. Ethja reumatizmale.</li> <li>21. Veset e lindura të zembrës.</li> <li>22. Veset e fituara të zembrës.</li> <li>23. Infeksionet e rrugëve urinare.</li> <li>24. Insuficienca renale akute.</li> <li>25. Veçoritë e infeksioneve tek moshat pediatrike.</li> <li>26. Fruthi. Rubeola.</li> <li>27. Variçela. Parotiti.</li> <li>28. Pertusis</li> <li>29. Poliomieliti.</li> <li>30. Tetanozi.</li> <li>31. Bruceloza.</li> <li>32. Difteria.</li> <li>33. Tuberkulozi.</li> <li>34. Salmonelozat.</li> </ol>		
45 orë leksione				

	<p>35. Shigeloza.</p> <p>36. Parazitozat.</p> <p>37. Dehidrimi dhe diarreja.</p> <p>38. Diabeti tip I, II.</p> <p>39. Hipotiroza kongenitale.</p> <p>40. Meningiti akut.</p> <p>41. Meningokoksemia.</p> <p>42. Encefaliti.</p> <p>43. Anemia ferriprive.</p> <p>44. Rakiti. Sindroma Reye.</p> <p>45. Sindroma e vdekjes së papritur të fëmijës. Helmimet tek fëmijët.</p>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ 'Pediatria' A.Saliaj, 2010 (Fakulteti i Shëndetit Publik - UV)</li> <li>○ 'Pediatria' D.Bebeci 2002 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ 'E përdorim apo e keqpërdorim teknologjinë' E.Tushe 2008 (Fakulteti i Mjekësisë - UT)</li> <li>○ 'Pediatria infermiere' H.Jazo, 2005</li> <li>○ 'Textbook of Paediatric' Nelson, 2008</li> <li>○ 'Maternity and Pediatric Nursing' Thompson 2010</li> </ul>

Emërtimi i modulit		<b>Sëmundje të brendshme I</b>		<b>KODI: INF 220</b>
Viti		II		
Semestri		I		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi i modulit		Në këtë modul përfshihen patologjitë kryesore të sistemit kardio-vaskular, pneumologjike, endokrine dhe reumatologjike. Gjatë këtij kursi studentët do të mësojnë të njohin klinikisht sëmundjet më të shpeshta të këtyre aparateve, të adresojnë menaxhimin e tyre dhe të ndërtojnë promocionin shëndetsor për to.		
Ngarkesa në orë	Auditor	106 orë		
	Studim individual	94 orë		
Kreditet		<b>8 ETCS = 200 orë</b>		
Format e mësimdhënies		<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Auditor (orë)</i>	<i>Studim (orë)</i>
	Leksione	4.5	45	67,5
	Praktika mësimore	3	60	15
	Projekte	0.5	1	11.5
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>106</b>	<b>94</b>
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik 45 orë leksione		<p><i>Kapitulli I - Sëmundjet e zezrës</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ekzaminimi i të sëmurit, të dhënat objektive, të dhënat subjektive, ekzaminimi instrumental.</li> <li>2. Sëmundjet e aparatit valvular, stenoza mitrale, insuficiencia mitrale.</li> <li>3. Prolapsi i valvulës mitrale, regurgitacioni i aortës.</li> <li>4. Stenoza e aortës, stenoza trikuspidale.</li> <li>5. Sëmundjet e lindura të zezrës. Komunikimet ndërartriale, ndërventrikulare.</li> <li>6. Tetrada Fallot, persistenca e kanalit artrial. Koarktacioni i aortës.</li> <li>7. Endokarditi infektiv.</li> <li>8. Sëmundja ishemiike e zezrës, të dhëna të përgjithshme mbi mekanizmat dhe faktorët e riskut të atherosklerozës.</li> <li>9. Angina pectoris.</li> <li>10. Infarkti akut i miokardit.</li> <li>11. Vdekja e papritur dhe ringjallja zemër-mushkërore.</li> <li>12. Hipertonia arteriale.</li> <li>13. Cor pulmonar kronik.</li> <li>14. Sëmundjet e perikardit, perikarditi akut.</li> <li>15. Tamponada e zezrës, perikardit kronik.</li> <li>16. Sëmundjet e miokardit, kardiomiopati.</li> <li>17. Kolapsi, shoku dhe sinkopet.</li> <li>18. Insuficiencia kardio-vaskulare.</li> <li>19. Çrregullimet e ritmit sinuzal, atrial, ventrikular.</li> <li>20. Çrregullimet e përçimit. Blloku sinoartrial.</li> <li>21. Blloku atrioventrikular, çrregullimet e përçimit interventrikular.</li> <li>22. Sëmundjet e aortës dhe programi i konvaleshencës.</li> </ol> <p><i>Kapitulli II - Sëmundjet e mushkrive</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>23. Semiotika klinike e aparatit respirator. Vlerësimi laboratorik, instrumental dhe radiologjik i aparatit respirator.</li> <li>24. Sëmundjet obstruktive bronkopulmonare: Astma bronkiale, Bronkopneumopatia kronike obstruktive, Bronkoektazia .</li> <li>25. Sëmundjet restriktive pulmonare: Fibroza pulmonare idiopatike, Pneumopatia nga hipersensibiliteti, Pneumopatia nga medikamentet, Pneumokonioza, Pneumopati të lidhura me sëmundje të indit konjuktiv, Sarkoidoza.</li> <li>26. Sëmundjet e Pleurës. Pneumotoraksi.</li> <li>27. Infeksionet e sistemit respirator. Bronkiti akut, influenza.</li> <li>28. Pneumonitë.</li> <li>29. Abcesi pulmonar dhe pneumonia nga aspiracioni.</li> <li>30. Tuberkulozi pulmonar.</li> <li>31. Sëmundjet vaskulare pulmonare: Embolia pulmonare.</li> <li>32. Hipertensioni pulmonar.</li> </ol>		

	<p>33. Sindromi i distresit respirator akut.</p> <p>34. Insuficienca respiratore .</p> <p>35. Apnea respiratore.</p> <p>36. Tumoret pulmonare- karcinoma pulmonare.</p> <p><i>Kapitulli III - Sëmundjet reumatizmale</i></p> <p>37. Artriti reumatoid.</p> <p>38. Lupusi eritematoz sistemik.</p> <p>39. Sklerodermia.</p> <p>40. Vaskulitet.</p> <p><i>Kapitulli IV – Geriatria dhe Gerontologjia.</i></p> <p>41. Çeshte Geriatria dhe Gerontologjia.</p> <p>42. Semundjet e Aparatit respirator ne moshat e treta.</p> <p>43. Semundjet Reumatizmale ne moshat e treta.</p> <p>44. Plakja aktive. ACTIVE AGING.</p> <p>45. Personaliteti i te moshuarit dhe AGEISMI.</p>
<i>Literatura bazë</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o “Sëmundjet e brendshme 1” . Fejzi Alushi 2008. (Fakulteti Shëndetit Publik- UV)</li> <li>o “Sëmundjet e brendshme” P.Barra, Xh.Ceka 2009 (Fakulteti i Infermierisë - UT)</li> </ul>
<i>Literatura ndihmëse</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>o Medicina Pratica II Edicione 1984 Aldo ZANGARA.</li> <li>o Medicina Interna. Carlo ZANUSSI, G Muisan, CA. SORBINI.</li> <li>o Semundjet e Mushkrive. Grup autoresh. Fakulteti i Mjeksise Tirane.</li> <li>o Reumatologjia. Grup autoresh. Fakulteti i Mjeksise Tirane.</li> <li>o Nursing. Practice and Health care 2003 Suzan. M.Hinchiff.</li> </ul>

Emërtimi i modulit		Sëmundje të brendshme II		KODI: INF 350
Viti		III		
Semestri		II		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Disiplinë e formimit karakterizues të programit		
Përshkrimi i modulit		Në këtë modul përfshihen patologjitë kryesore të gastro-hepato-enterologjisë, nefrologjisë dhe hematologjisë. Gjatë këtij kursi studentët do të mësojnë të njohin klinikisht sëmundjet më të shpeshta të këtyre aparateve, të adresojnë menaxhimin e tyre dhe të ndërtojnë promovimin shëndetësor për to.		
Ngarkesa në orë	Auditor	106 orë		
	Studim individual	94 orë		
Kreditet		8 ETCS = 200 orë		
Format e mësimdhënies		Kredite (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
		Sëmundje e brendshme = 5.5 ECTS		
	Leksione	3	30	45
	Praktika mësimore	2	40	10
	Projekte	0.5	1	11.5
		Gerontologjia dhe geriatra = 2.5 ECTS		
	Leksione	1.5	15	22.5
	Praktika mësimore	1	20	5
	<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	<b>106</b>	<b>94</b>
Temat që do trajtojë lënda në formimin teorik		<p><i>Kapitulli I – Sëmundjet e aparatit urinar.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Nocione të përgjithshme mbi anatomofiziologjinë e aparatit urinar.</li> <li>Vlerësimi laboratorik, instrumental e imazherik.</li> <li>Infeksionet akute e kronike të aparatit të sipërm dhe të poshtëm urinar.</li> <li>Pielonefriti akut. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi.</li> <li>GNA .Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi.</li> <li>Sindromet nefritike. Sindromi nefrotike.</li> <li>IRA. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi.</li> <li>Hipertensioni renovaskular dhe renoparenkimatoz</li> <li>Reni policistik tek adultët.</li> <li>IRK. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi</li> <li>Terapia zëvendësuese. Hemodializa, dializa peritoneale dhe transplant</li> </ol> <p><i>Kapitulli II – Sëmundjet e aparatit hemopoetik.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Nocione të përgjithshme anatomofiziologjike. Manifestimet klinike të sëmundjeve hematologjike. Vlerësimi klinik, laboratorik e instrumental.</li> <li>Anemitë ferodeficitare. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi.</li> <li>Anemitë hemolitike. Drepanocitoza. Talasemitë. Talasemia major. Anemite hipoplazike dhe aplazike</li> <li>Leukozat akute. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi.</li> <li>Leukozat kronike. Etiopatogjeneza, klinika, mjekimi.</li> <li>Morbus Hodgkin.</li> <li>Trombopenitë, Purpura trombocitopenike idiopatike.</li> <li>Hemofililitë. Etiopatogjeneza, klinika, trajtimi.</li> <li>Mjekësia transfuzionale dhe transplant i medulla ossea.</li> </ol> <p><i>Kapitulli III – Sëmundjet e aparatit gastrointestinal.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Nocione mbi anatominë dhe fiziologjinë e aparatit tretës. Manifestimet klinike të sëmundjeve të aparatit tretës. Vlerësimi laboratorik, instrumental dhe radiologjik.</li> <li>Sëmundjet ezofagut. RGE, Ezofagiti kaustik. Kanceri i ezofagut</li> <li>Sëmundjet e stomakut dhe duodenit: Gastriti akut dhe kronik. Gastritet nga Helicobakteri Pylori. Sëmundja ulçeroze gastroduodenale e duodenitet.</li> <li>Kanceri i stomakut.</li> <li>Sëmundjet e intestinit: Sindromi i malabsorbimit. Kolon iritabël. Morbus Crohn</li> <li>Rectokolitis ulceroza. Karcinoma e kolorektal</li> </ol> <p><i>Kapitulli IV – Sëmundjet e heparit, kolecistës dhe pankreasit.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Nocione të përgjithshme mbi anatominë dhe fiziologjinë e heparit</li> </ol>		
45 orë leksione				

	<p>28. Hepatiti kronike. Cirroza hepatike. Hepatokarcinoma.  29. Sëmundja e pankreasit. Pankreatiti akut dhe kronik.  30. Sëmundjet e colecystes. Colecistiti akut e kronik.</p> <p><i>Kapitulli IV - Sëmundjet endokrine</i></p> <p>31. Nocione të përgjithshme mbi sistemin endokrin.  32. Sëmundjet e hipofizës(anteriore e posteriore). Sindroma Cushing. Gjigantizmi e Acromegalia. Diabeti insipid.  33. Sëmundjet e tiroides. Hipertiroidizmi. Tiroiditet. Struma endemike.  34. Sëmundjet e gjëndrave surrenale.  35. Diabeti melitus.</p>
